



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDYSHE

Analizë e shkurtër
Sfidat e prokurimit publik në Komunën e Prizrenit
Nëntor 2018, Prizren

PËRMBAJTJA

I. Hyrje.....	2
II. Sfidat e prokurimit publik në Komunën e Prizrenit	3
III. Gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.....	5
IV. Rastet specifike.....	8
V.Rekomandimet.....	13

I. Hyrje

Prokurimi publik sipas përkufizimit të dhënë nga organet shtetërore të Kosovës do të thotë një blerje, kontratë formale apo tjetër, e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve nga organet publike, të cilat shfrytëzojnë mjetet financiare publike. Prokurimi publik përfshinë blerjen, marrjen me qira ose marrjen me ndonjë mjet tjetër kontraktual, të mallrave, punëve ndërtimore dhe shërbimeve të nevojshme publike nga sektori publik. Prokurimi publik gjithashtu përfshin situatat në të cilat fondet publike mobilizohen për të blerë mallra, punë dhe shërbime edhe në qoftë se Qeveria nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë.¹

Në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2017-2021 theksohet se prokurimi publik është jetik për ekonominë e vendit dhe se për këtë arsye ky shpenzim shumë i rëndësishëm publik duhet të udhëhiqet nga një grup parimesh publike, vlerat, praktikat më të mira, ligjet, rregulloret dhe procedurat.²

Ndërsa Zyra Kombëtare e Auditimit ka sqaruar se rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Sipas ZKA-së, korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e prokurimit. Kjo përfshinë kërkesën për të ulur

¹ Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2017-2021, KRPP, janar 2017, linku: <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Strategjia%20per%20Prokurimin%20Publik%202017%202021/Strategjia%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf>, qasur me 3 shtator 2018

² Po aty

rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët.³

Sistemi i Prokurimit në Kosovë në vazhdimësi është reformuar dhe plotësuar. Por me gjithë përparimin në kornizën ligjore dhe institucionale, përpjekjet për avancimin e sistemit siç ceket edhe në Strategjinë Kombëtare duhet të intensifikohen sidomos në aspektet e rritjes së efikasitetit, transparencës, llogaridhënës dhe rritjes së profesionalizimit të stafit përgjegjës për menaxhimin e sistemit.

Sfida të ndryshme janë hasur në tërë procesin duke filluar nga planifikimi e deri te realizimi i projekteve. Këto mund të çojnë në një situatë ku do të prokuroheshin mallra dhe shërbime dhe projekte kapitale, të cilësisë jo të duhur dhe me kosto më të lartë.⁴

Strategjia thekson se sistemi modern i prokurimit publik kërkon standarde të larta të efikasitetit dhe transparencës pasi që prokurimi publik bëhet për interes të publikut dhe është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm. Përgjegjësia dhe llogaridhënia, sikurse edhe Komunikimi dhe informimi janë po aq të rëndësishme.

³ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, ZKA, qershor 2016, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/RaportiAuditimit.KPZ.2015.Shqip.550195.pdf>, qasur me 5 shtator 2018

⁴ Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2017-2021, KRPP, janar 2017, linku: <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Strategjia%20per%20Prokurimin%20Publik%202017%202021/Strategjia%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf>, qasur me 3 shtator

Madje llogaridhënia ashtu siç shkruan në Strategjinë e lartpërmendur përbën shtyllën qendrore të çdo sistemi të prokurimit publik, pasi që pa sisteme transparente dhe të përgjegjshme që ia mundësojnë institucioneve dhe qytetarëve që të angazhohen në mënyrë reciprokisht të përgjegjshme, burimet e mëdha të kanalizuar nëpërmjet sistemeve të prokurimit publik mundësojnë rrezikun e rritjes së korrupsionit dhe të keqpërdorimit të fondeve. Pikërisht, çështja e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë në sistemin e prokurimit publik të Kosovës mbetet një sfidë.⁵

Organizatrat e shoqërisë civile kanë bërë të ditur se në historinë e re të Kosovës, fusha e prokurimit publik gëzon standard të ulët të besueshmërisë, për faktin se si instrument i shpenzimit të parasë publike, në masë të konsiderueshme ka shërbyer për keqpërdorime të theksuara nga akterë të ndryshëm publik e privat. Në rrugëtimin shtetndërtues, prokurimi publik në vazhdimësi është karakterizuar me tranzicionin legjislativ me ç'rast ndryshimet në këtë fushë në vazhdimësi mbetën në tentativë për ta bërë një sistem sa më funksional të prokurimit publik. Përkundër kësaj, problemet me të cilat vazhdon të karakterizohet prokurimi publik janë të theksuara pothuajse në të gjitha nivelet.⁶

Ndërkaq Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i publikuar në vitin 2018, vë në pah se sa i përket përafrimit me standardet

⁵ Po aty

⁶ Integriteti dhe (pa)ndëshkueshmëria në prokurim, Koalicioni për Hapje të të Dhënave dhe Llogaridhënie në Prokurim Publik – Pro Open, maj 2018, linku: <https://kfos.org/integriteti-dhe-pandeshkueshmeria-ne-prokurim/>, qasur me 3 tetor 2018.

evropiane, Kosova është në një fazë të hershme. Ky raport thekson se pak përparim është arritur në fushën e prokurimit publik. Aty nënvizohet se duhet të bëhet më shumë për të parandaluar parregullsitë dhe korrupsionin në ciklin e prokurimit. BE-ja nga Kosova pret që të adresohet kapaciteti i dobët i institucioneve të prokurimit publik për administrimin e prokurimit publik, monitorimin dhe ekzekutimin e pamjaftueshëm të kontratave, si dhe sistemet e dobëta të mjeteve juridike, ku sipas BE-së të gjitha janë të cenueshme ndaj korrupsionit në rastin e prokurimit publik. Në raport ceket se Kosova duhet të rrisë kapacitetin e të gjitha institucioneve të prokurimit publik për administrimin e prokurimit publik, si dhe të përforcojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e ciklit të plotë të tenderimit.⁷

Në këtë aspekt, nuk bën përjashtim as Komuna e Prizrenit, ku sfidat e prokurimit publik janë të numërta.

II. Sfidat e prokurimit publik në Komunën e Prizrenit

Komuna e Prizrenit ka planifikuar që në vitin 2018 t'i shpenzojë 17.4 milionë euro përmes procedurave të prokurimit. Prej kësaj shume, pjesa më e madhe do të shkojë në kontraktimin e punëve, në vlerë prej 14.1 milionë euro, derisa për furnizime janë planifikuar rreth 1.8 milionë euro si dhe për kategorinë e shërbimeve afër 1.5 milionë euro. Në kategorinë e furnizimeve në planin vjetor të Prokurimit janë 33 projekte, në kategorinë e shërbimeve 38 projekte dhe në kategorinë e punëve janë 178 projekte.

⁷ Raporti i KE për Kosovën, prill 2018, linku: http://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo_report_2018_shqip.pdf, qasur me 7 tetor 2018.

Zyra e Prokurimit në Komunën e Prizrenit ka bërë të ditur se nuk ka asnjë sfidë.⁸ Por leximi i raporteve të organeve shtetërore tregon se ka probleme në këtë komunë në aspektin e prokurimit. Madje me paraqitjet publike një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga vet lidhshipi komunal, lidhur me projektet përkatësisht kontratat e ndryshme të mandatit të shkuar qeverisës.

Raporti i punës për vitin 2017, i Organit Shqyrtues të Prokurimit, ofron dëshmi në këtë drejtim. Gjatë vitit 2017, OSHP-ja kishte shqiptuar gjithsej katër gjoba autoriteteve kontraktuese për mosrespektim të vendimeve të paneleve shqyrtuese. Njëra nga to ka qenë për Komunën e Prizrenit dhe atë në vlerë prej 5 mijë eurove.⁹

Ndërkaq raportet e publikuara në vitet e fundit nga Zyra Kombëtare e Auditorit shpalosin sfida të ndryshme në raport me prokurimin publik në Komunën e Prizrenit.

Në Raportin e Auditimit të publikuar në qershor të vitit 2018, te konkluzionet dhe rekomandimet kryesore, ndër të tjera shkruan se ekzistojnë mangësi edhe në lidhje me procedurat e prokurimit. Auditori ka identifikuar raste kur Komuna ka lidhur kontrata publike jashtë planit vjetor të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), dhe ku nuk janë ndjekur procedurat e rregullta për sigurimin e konfirmimit nga Autoriteti Qendror i Prokurimit për inicim të procedurave

⁸ Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit, Përgjigje me email, datë 16 nëntor 2018.

⁹ Raporti vjetor i Punës 2017, OSHP, shkurt 2018, linku: <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/Raport-vjetor-finac2017.pdf>, qasur me 2 nëntor 2018.

për projektet të cilat nuk janë të përfshira në planin e prokurimit publik. Gjithashtu ZKA ka gjetur procese të prokurimit, ku komuna kishte lidhur kontrata publike në mungesë të Projektit Ekzekutiv, sikurse edhe raste kur kontratat janë nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve.¹⁰ Këto gjetje dhe të tjera të ZKA-së në raport me prokurimin publik të Komunës së Prizrenit do të paraqiten në kapitullin e mëposhtëm.

Në të njëjtën kohë edhe lidhshipi komunal i Prizrenit, që ka dalë nga zgjedhjet e fundit komunale gjatë këtij viti ka dalë me qëndrime publike se projektet e caktuara nuk është dashur të tenderohen, pa u kryer projekti i detajuar i implementimit. Sipas tyre edhe menaxhimi i kontratave të caktuara nuk ka qenë në nivel të duhur, duke ngritur dyshime për dëmtimin e buxhetit komunal. Pos kësaj edhe akterë të tjerë të prokurimit publik, kanë adresuar pretendime për shkelje ligjore nga ana e zyrtarëve të Komunës së Prizrenit në raport me aktivitetin e prokurimit.

Në bazë të monitorimit të këtij sektori del se sfidat e prokurimit në Komunën e Prizrenit nuk janë të ndërlidhura vetëm me Zyrën e Prokurimit, por se ato duhen analizuar në aspektin strukturor dhe në ndërlidhje të ngushtë edhe me lidhshpin politik komunal e sidomos njësitë kërkuese, ku këto të fundit më pas e bëjnë menaxhimin e kontratave. Si praktikë e mirë mund të ceket publikimi i njoftimeve për aktivitetet e prokurimit publik

¹⁰ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, ZKA, qershor 2018, linku: http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_KPZ_2017_Shqip.pdf, qasur me 1 nëntor 2018.

në ueb faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit, ndërkohë që nga gushti i vitit 2018 ka filluar edhe publikimi i kontratave të nënshkuara.

III. Gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit, i publikuar në qershor të këtij viti, te konkluzionet dhe rekomandimet kryesore ndër të tjera pohon se ekzistojnë mangësi në lidhje me procedurat e prokurimit.¹¹

Si rezultat i moszbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë edhe me prokurimin.

Auditori ka gjetur pagesa për mallra dhe shërbime pa procedura të prokurimit.

-Sipas ZKA-së pagesa në vlerë 4,000€, për sigurimin e automjeteve është bërë pa procedura të prokurimit, pasi që komuna nuk ka pasur kontratë me ndonjë Operator Ekonomik për sigurimin e automjeteve. Auditori ka theksuar se Ligji i prokurimit publik nuk e përjashton këtë lloj të shpenzimit nga procedurat.

-Në pagesën në vlerë 10,578€ për mirëmbajtjen e automjeteve, sipas Auditorit, Komuna ka paguar shumë prej 5,504€ për artikujt të cilat nuk janë të parashikuar në kontratë. Sipas kontratës së nënshkruar në mes komunës dhe OE, në pamundësi të përfshirjes së të gjitha pjesëve të cilat janë objekt i furnizimit dhe ndërrimit, formohet një komision nga ana e komunës për furnizimin e tyre sipas çmimeve të tregut që bije në kundërshtim me nenin 1 dhe 4

të kontratës. Gjatë testimit të pagesës Auditori nuk ka gjetur dëshmi të formimit të komisionit, por vetëm faturim nga ana e OE.

ZKA ka identifikuar dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale.

-Në raport theksohet se te projekti “Rregullimi i shtratit të Lumëbardhit”, komuna ka zhvilluar procedurat tenderuese, si dhe është nënshkruar kontrata, mirëpo paralelisht me këtë Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë kërkesë në Urbanizëm për lejimin e kushteve ndërtimore (lejes së ndërtimit). Si pasojë është kërkuar nga kontraktuesi të mos fillojë punimet derisa të sigurohet leja ndërtimore.

-Komuna nuk ka zhvilluar procedura të prokurimit për projektin “Ndërtimi i rrugës Faridin Hoti”, “Ndërtimi i QMF-së në fshatin Gjonaj” në vlerë 120,000€ dhe “Furnizimi me GPS për matje kadastrale” në vlerë prej 10,000€ edhe pse ishin planifikuar me planin e prokurimit.

-Në katër raste (Ndërtimi i rrugës lokale në Vlashnje të Prizrenit: 183,837€; Renovimi i sallës së edukatës fizike në gjimnazin Gjon Buzuku: 249,441€; Rregullimi i ambientit turistik në Cvilen: 16,988€; dhe Ndërtimi i ambientit rreth lapidarit Besim Ndrecaj: 9,497€), Komuna ka lidhur kontrata publike jashtë planit vjetor të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), dhe nuk janë ndjekur procedurat e rregullta për sigurimin e konfirmimit nga Autoriteti Qendror i Prokurimit për inicim të procedurave për projektet të cilat nuk janë të përfshira në planin e prokurimit publik.

Për kontratën “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Legjendë-Malësi e Re” në kuadër të faturës dhe

¹¹ Po aty

pagesës në vlerë 98,725€, ishin edhe dy pompa zhytëse në vlerë 4,000€ të cilat nuk ishin funksionalizuar ende. Ky pozicion i paraparë në kontratat, është pranuar nga menaxheri i kontratës, organi mbikëqyrës dhe çertifikuar/paguar sipas situacionit nr.4 për furnizim, transportim dhe montim të dy pompave zhytëse H=80m, Q=6.8 l/sek. Gjatë ekzaminimit të auditorit me prezencën edhe të organit mbikëqyrës të kontraktuar nga komuna, pompat nuk ishin montuar dhe nuk funksionin ende. Arsyetimi i organit mbikëqyrës ishte se për shkak të punimeve të papërfunduara, montimi i tyre në aspektin fizik nuk ishte i sigurt.

-Te kontrata “Furnizimi me material ndërtimor për raste emergjente” komuna ka pranuar faturën, dhe ka kryer pagesën në vlerë 4,000€ edhe pse sipas pozicioneve të materialit të faturuar nga OE, vlera e përgjithshme e pranimit të mallit ishte vetëm 2,198€ (sipas fletëpranimit). Situacioni është nënshkruar (nga menaxheri i kontratës dhe organi mbikëqyrës përgjegjës) dhe pagesa është çertifikuar për 1,802€ më shumë se sa mallrat e pranuar. Gjatë ekzaminimit në teren me prezencën edhe të organit mbikëqyrës, vërtetohet se mallrat e pranuar ishin në vlerë 2,198€.

ZKA ka konstatuar edhe planifikim dhe menaxhim të dobët të kontratave.

Komuna nuk kishte arritur të vendos kontrollin e duhur në menaxhimin e kontratave si: Në dy procese të prokurimit “Rregullimi i ambientit turistik në Cvilen” në vlerë 16,987€ dhe “Riparimi i rrugës nga Restoranti Natyra deri tek Kalaja” në vlerë prej 6,900€, komuna kishte lidhur kontrata publike në mungesë të Projektit Ekzekutiv. Sipas nenit 28, pika 10, të LPP-së, Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa

bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Sipas rregullës financiare për shpenzimin e parasë publike asnjë kontratë publike nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të mjeteve. Në 10 raste kontratat janë nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale e kontratave të nënshkruara ishte 3,641,742€, derisa zotimi i mjeteve për to ishte vetëm 287,000€ ose afërsisht 8%. Sipas zyrtarëve të komunës mosalokimi me kohë i të hyrave vetjake ka rezultuar me nënshkrim të kontratave pa zotim të plotë të mjeteve.

ZKA ka gjetur edhe shmangie nga procedurat e rregullta të prokurimit.

Në procesin e prokurimit “Furnizim me material ndërtimor për familjet skamnore” komuna kishte eliminuar nga gara OE i cili kishte ofertuar me çmimin më të lirë për arsyet se nuk kishte plotësuar dy kritere: “Projektet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit minimumi 370,000€” dhe “Pasqyrat financiare të kompanisë të shoqëruar me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit”. Pas ankesës së OE-së, OSHP-së ka vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim sepse komuna ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 të LPP-së. Pas vendimit të OSHP-së, komisioni për vlerësim të tenderëve kishte shpallur përsëri të papërgjegjshëm OE më të lirë (edhe pse posedonte të gjitha dëshmitë) dhe kishte nënshkruar kontratë me OE e dytë me radhë në vlerë 199,344€ ose për 6,096€ më shumë se sa OE më i lirë.

Prej 350 procedurave të kryera në prokurim, në 220 raste apo 63% prej tyre, janë përdorur procedurat e kuotimit të çmimeve dhe atyre me vlerë minimale. Për “Dezinfektim, deratizim, dezinfektimin” në QKMF, është nënshkruar një

kontratë (26.04.2017) në vlerë prej 3,971€, pastaj kontrata tjetër me procedura të hapura është nënshkruar (04.05.2017) në vlerë prej 34,016€, si dhe dy kontrata me vlera minimale. Ngjashëm ka ndodhë edhe me furnizimin me material zyrtar; furnizimi me inventar; furnizim me perde, ku për furnizime të njëjta ishin nënshkruar nga tri apo më shumë kontrata me vlera minimale.¹²

Në raportin e Auditimit të publikuar nga ZKA-ja në qershor të vitit 2017, te konkluzionet dhe rekomandimet kryesore shkruan se prokurimi kërkon ende përmirësime.¹³

ZKA kishte shpalosur gjetjet se Komuna ka nënshkruar kontratë pa procedura të prokurimit. Pastaj ka konstatuar se Komuna ka hyrë në obligime pa i zotuar të gjitha mjetet e nevojshme.

ZKA ka gjetur se Komuna kishte lidhur 3 kontrata publike kornizë për punë me çmim për njësi për mirëmbajtje për 36 muaj (Instalimi i ndriçimit publik, mirëmbajtja e rrugëve lokale me kubëza, intervenimi në infrastrukturë në rast të fatkeqësive natyrore) jo në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) duke mos përcaktuar në dosje të tenderit sasinë indikative ose vlerën e parashikuar të kontratës. ZKA ka përkujtuar se sipas nenit 38 të LPP “Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej

tij duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)”. Mospërcaktimi i sasive ose vlerës së parashikuar në kontratë sipas Auditorit do ta bëjë të pamundur për të përcaktuar pragun e devijimit të lejuar me ligj.

Ne kemi vërejtur se te kontratat “Renovimi i Kulmit në QKMF” me vlerë 42,220€ komuna nuk kishte bërë hartimin e projektit ekzekutiv. Neni 28.10 i LPP-së për specifikimet teknike për kontratat për punë ndër të tjera thekson se “Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit, pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit”.

Rekomandimi i ZKA-së ka qenë që Zyra e Prokurimit të përgatis dosjet e tenderit sipas kërkesave të LPP dhe të specifikojë qartë sasinë e përafërta indikative të punëve ose vlerën e parashikuar të kontratës. Po ashtu, ZKA ka rekomanduar që të mos iniciohen aktivitete të prokurimit pa hartimin e projekteve ekzekutive.

Ngjashëm, ZKA-ja edhe në raportin e Auditimit të Publikuar në vitin 2016, kishte theksuar se ekzistojnë dobësi sistematike në prokurimin e Komunës së Prizrenit, ku disa kontrolle menaxheriale nuk janë zbatuar me konsistencë gjatë prokurimeve.¹⁴

¹² Po aty

¹³ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016, ZKA, qershor 2017, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/RaportiAuditimit.KPZ.2016.Shqip.295743.pdf>, qasur me 4 nëntor 2018.

¹⁴ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, ZKA, qershor 2016, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/RaportiAuditimit.KPZ.2015.Shqip.550195.pdf>, qasur me 4 nëntor 2018.

IV. Rastet specifike

Në kuadër të këtij hulumtimi EC ka veçuar disa projekte specifike, ku përkundër zbatimit të procedurave të prokurimit dyshohet se fondet publike nuk janë përdorur në mënyrë efikase për të arritur vlerën për para; pastaj ku hyrja në procedura të prokurimit është bërë pa i përmbushur të gjitha kriteret ligjore; po ashtu pretendimet e pushtetit aktual ndaj ish-pushtetit lidhur me prokurimin dhe menaxhimin e disa kontratave, ku janë adresuar edhe akuza për keqpërdorime, pastaj edhe një projekt që ka rezultuar me moszbatimin e vendimeve të OSHP-së si dhe padi të afaristit ndaj lidershipit komunal.

a) **Historia e gjatë e ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës në Zhur**

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Komunën e Prizrenit¹⁵ realizimi i projektit “Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës në Zhur” është bërë në disa faza, duke filluar nga viti 2009, të cilat buxhetit të Komunës i kanë kushtuar afër 1 milionë euro dhe kjo Shtëpi e Kulturës ende nuk është funksionale.

Faza e parë e këtij projekti sipas DKRS është realizuar në bazë të kontratës nr.:622-09-204-521 me datë 24.09.2009 në vlerë prej 295,141.33 €. Për punimet e rrënimit të objektit të vjetër Shtëpisë së Kulturës në Zhur, është nxjerrë konkluzioni nga Kryetari i Komunës nr.:01/06-zyrtar më datë 30.09.2010 dhe janë realizuar me aneks kontratë nr.:622-09-204-521 të datës 24.09.2009 në vlerë prej 9,649.20 €.

¹⁵ Përgjigje me shkrim e DKRS-së, në pyetjen e z. Behar Begaj - anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, datë 29 mars 2018.

Që faza e parë të përfundohet është dashur të zhvillohen punime shtesë, dhe për këtë është nxjerrë konkluzioni nga Kryetari i Komunës nr.:01/06-2767 datë 27.07.2010 punimet janë realizuar me aneks kontratë nr.:622-09-204-521, datës 24.09.2009 në vlerë prej 29,484.96 €.

Më pas është zhvilluar një fazë tjetër e punimeve, me kontratë nr.:622-13-138-521 më datë 01.07.2013 në vlerë prej 69,809.00.

Pastaj është zhvilluar edhe faza tjetër e punimeve, Realizimi i projektit - Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës në Zhur (faza e dytë) e cila është bërë me kontratë nr.:622-10-275-511 dhe është nënshkruar më 22.12.2010 në vlerë prej 526,210.06 €. Gjatë realizimit të punimeve të fazës së dytë në projekt janë vërejtur disa lëshime, andaj OE është dashur t'i realizoj si punime shtesë. Kështu që është nxjerrë konkluzioni nga Kryetari i Komunës nr.:01/06-9147 më datë 21.08.2012 për punime shtesë (faza e parë dhe e dytë) në vlerë prej 52,000.00 €.

Edhe përkundër këtyre investimeve Shtëpia e Kulturës në Zhur nuk është funksionale. Sipas DKRS-së ajo është dëmtuar.

Në mars të këtij viti një Komision komunal për vlerësimin e dëmit të shkaktuar në Shtëpinë e Kulturës në Zhur, ka konstatuar se: Hidroizolimi i objektit në terasën e kulmit është komplet jashtë funksionimit si pasojë e të cilit në objekt ka rrjedhje të ujit, (sanimi i hidroizolimit është kusht elementar zhvillimit të punimeve të mëtutjeshme); ka defekte në fasadën strukturale, nga ku depërton uji; dëmtimi i dyshemesë në katin e dytë – laminatit, ka ardhur si pasojë e depërtimit të ujit nga mosfunksionimi i hidroizolimit. Ndërkohë që dëme janë shkaktuar edhe nga personat që dhunshëm kanë hyrë në objekt më 16.02.2018,

si demolimi i karrigeve, ngjyra e derdhur në sipërfaqen e dyshemesë së hollit në katin përdhës mbi pllakat e qeramikës dhe në ËC, dyert e demoluara me dritaret e thyera.¹⁶

Përmes një peticioni, banorët e këtij lokaliteti në dhjetor të vitit 2016 patën kërkuar nga autoritetet komunale që të bëhet ekspertiza mbi qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e objektit.

Në Raportin e Auditorit të publikuar në qershor të vitit 2016 shkruan se Komuna kishte nënshkruar një aneks kontratë në vlerë 52,000€, duke u bazuar në kontratën bazë “Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Zhur” e nënshkruar me datën 22.12.2010. Sipas organit mbikëqyrës deri me datën 18.12.2012, ishin kryer të gjitha pagesat ndaj operatorit ekonomik, ende pa përfunduar punimet. Punimet nuk janë përfunduar për arsye se operatori ekonomik kishte pretenduar se ka kryer punë shtesë, pikërisht për vlerën që i është dhënë përmes aneks kontratës. Analizat e bëra nga Auditori kanë konstatuar se janë kryer punime jashtë kontratës bazë, qysh në vitin 2012, dhe se KK-së i është kërkuar që me rishikim të buxhetit të ndaj mjete për përfundimin e disa pozicioneve që kishin përfunduar më herët.¹⁷

EC ka kërkuar sqarime nga Zyra e Prokurimit në Komunën e Prizrenit se ky qëndron problemi në këtë rast, te prokurimi apo te mbikëqyrja e

¹⁶ Po aty

¹⁷ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, ZKA, qershor 2016, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/RaportiAuditimit.KPZ.2015.Shqip.550195.pdf>, qasur me 4 nëntor 2018.

zbatimit të projektit. Përgjigja që ka marrë nga kjo Zyra ka qenë: “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Zhur ka filluar në vitin e largët 2009. Ende po vazhdon historia e kësaj Shtëpie”.¹⁸

Përkundër zbatimit të procedurave të prokurimit mos finalizimi i këtij projekti dhe mos vënia në funksion e ndërtesës në fjalë, përkundër shpenzimit të mjeteve të konsiderueshme të parave nga buxheti komunal, ngjallë dyshimin që fondet publike në këtë rast nuk janë përdorur në mënyrë efikase për të arritur vlerën për para.

b) Teleferiku për në Kalanë e Prizrenit - Hyrja në procedura të prokurimit pa i përmbushur të gjitha kriteret ligjore

Projekti i “Teleferikut për në Kalanë e Prizrenit”, vitin e kaluar, pat hyrë në procedurë të prokurimit, ani pse nuk ishin përmbushur të gjitha kriteret ligjore që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore dhe zonat e mbrojtura. Autoritetet e trashëgimisë kulturore patën refuzuar projektin ideor të Komunës së Prizrenit për ndërtimin e infrastrukturës për qasje në Kalanë e Prizrenit. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore/IKMM në kuadër të MKRS-së pat rekomanduar refuzimin e projektin ideor për ndërtimin e infrastrukturës qasje në Kalanë e Prizrenit, pasi që i njëjti është në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të dhëna nga IAK-u, si dhe në kundërshtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

Përkundër këtij fakti Ekzekutivi i kaluar lokal pat vazhduar procedurat e prokurimit për këtë

¹⁸ Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit, Përgjigje me email, datë 16 nëntor 2018.

projekt, me arsyetimin se autoritetet e trashëgimisë kulturore i kanë shkelur afatet ligjore për dhënien e përgjigjes ndaj kërkesës.

Zyra e Prokurimit në Komunën e Prizrenit ka sqaruar se projekti i teleferikut në momentin e inicimit të procedurës së prokurimit ka pasur leje të ndërtimit të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit. Sipas ZP-së, i takon Urbanizimit të sqarojë nëse leja është lëshuar në përputhje me kushtet dhe kriteret të cilat parashohin dhënien e lejes.¹⁹

Pas ndryshimeve në pushtetin lokal të Prizrenit, Ekzekutivi i ri në vitin 2018 pat kërkuar anulimin e aktivitetit të prokurimit për projektin e ndërtimit të teleferikut.

Në qershor të këtij viti, Komuna e Prizrenit sërish pati anuluar aktivitetin e prokurimit për këtë projekt, pasi Komisioni i vlerësimit pat konstatuar se me rastin e dhënies së lejes së ndërtimit për këtë projekt nuk janë respektuar ose janë shkelur tri ligje, të cilat i rregullojnë ndërtimet në Zonën historike, si: Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Ligji për Zonën Historike dhe Ligji për Planifikim Hapësinor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pat konfirmuar anulimin e aktivitetit të prokurimit për ndërtimin e teleferikut për qasje më të lehtë në Kalanë e Prizrenit, pasi pat marrë parasysh argumentet e ofruara nga Komuna e Prizrenit. Në arsyetimin e këtij vendimi shkruante se "autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit është bazuar në aktvendimin e datës 15 maj 2017, të lëshuar nga DUPH-ja, ku në pikën VII të këtij Aktvendimi shkruan se 'ky aktvendim pushon të vlejë në

¹⁹ Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit, Përgjigje me email, datë 16 nëntor 2018.

rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit për 12 muajsh, duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit". OSHP ka konstatuar se ka kaluar afati 12 mujor dhe se aktiviteti i prokurimit nuk është përfunduar akoma. Komuna e Prizrenit me rastin e anulimit ishte bazuar në dispozitat e Ligjit për ndërtim, ku thuhet se leja ndërtimore pushon së vlejuri nëse aplikuesi nuk fillon ndërtimin në afatin prej një viti nga dita e fuqizimit të lejes.

c) **Rregullimi i shtratit të Lumëbardhit - Hyrja në procedura të prokurimit pa i përmbushur të gjitha kriteret ligjore**

Sipas raportit të fundit të ZKA-së për Komunën e Prizrenit, te projekti "Rregullimi i shtratit të Lumëbardhit", Komuna ka zhvilluar procedurat tenderuese, si dhe është nënshkruar kontrata, mirëpo paralelisht me këtë Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë kërkesë në Urbanizëm për lejimin e kushteve ndërtimore (lejes së ndërtimit). Si pasojë është kërkuar nga kontraktuesi të mos fillojë punimet derisa të sigurohet leja ndërtimore.

Komuna e Prizrenit ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e shtratit të lumit "Lumëbardhi", që buxhetit lokal e qendror pritet t'i kushtojë më shumë se 1 milion euro.

Lidershipi aktual komunal ka pohuar se kontrata për këtë projekt është e nënshkruar, por se ka mundësi që të shkohet në rishikim të tij nëse ka hapësirë ligjore për këtë, teksa është konfirmuar edhe fakti se projekti nuk ka pëlqimet e duhura nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturore i Qendrës Historike të Prizrenit. Sipas lidershipit komunal veprimet në këtë projekt do të jenë në atë mënyrë që të mos ketë pasoja negative financiare për komunën, por as betonizim të lumit.

EC ka kërkuar sqarime nga Zyra e Prokurimit se përse pas nënshkrimit të kontratës po shkohet në rishikim të projektit. Zyra e Prokurimit ka theksuar se ajo është përgjegjëse deri në nënshkrim të kontratës për secilin proces të Prokurimit dhe se pas nënshkrimit të kontratës të gjitha përgjegjësitë e implementimit të kontratës kalojnë tek Menaxheri i kontratës.

d) Akuzat e pushtetit aktual ndaj ish-pushtetit lidhur me prokurimin dhe menaxhimin e disa kontratave

Në maj të këtij viti menaxhmenti aktual i Komunës së Prizrenit ka akuzuar ish administratën lokale për keqpërdorime në disa projekte. Kryetari i Komunës, Mytahir Haskuka dhe drejtori i Administratës, Osman Hajdari, në një konferencë për medie patën theksuar se Prokurori i Shtetit në bazë të detyrës zyrtare duhet të hetojë realizimin e kontratave për E-kiosqet, Arkivin elektronik, Aplikacionin “Smart City”, si dhe ndërtimin e zyrave të vendit në Gjonaj e Lubizhdë. Sipas tyre ekzistojnë dyshime të bazuara se me këto projekte është dëmtuar buxheti i Komunës.

Haskuka pat pohuar se janë vendosur 8 e-kiosqe, në qytet dhe fshatra, ku vlera e projektit ka qenë 68 mijë euro, dhe se asnjëra prej tyre nuk është funksionale (Muaj më vonë një e-kiosk është funksionalizuar te ndërtesa e Komunës.

Projekti i dytë problematik, sipas Haskukës ku nuk është kryer asnjë punë, por vetëm janë dhënë paratë është arkiva elektronike. Ai ka theksuar se një firmë është dashur ta realizojë arkivin elektronik, në vlerë prej 73 mijë euro, por pothuajse kurrë nuk është bërë. Në këtë rast sipas tij 30 mijë euro janë paguar, është pranuar fatura prej qeverisë së kaluar dhe kërkohet pagesa e pjesës së mbetur.

Projekti tjetër që ka veçuar ka qenë ai i aplikacionit “Smart City”, që figuron me kontratën në vlerë prej 24 mijë euro, porse sipas Haskukës përmes përmbaresit nga buxheti komunal janë marrë 28 mijë euro. Ky aplikacion për telefona të mençur, sipas tij funksionon vetëm në Android dhe jo në IOS.

Sipas tij edhe ndërtimi i objekteve të zyrave të vendit në Lubizhdë dhe Gjonaj, janë projekte problematike sa i përket pranimit teknik të tyre.

Sipas drejtorit Osman Hajdari në tri projektet e para komisionet e para të vendosura kanë dhënë dorëheqje dhe janë vendosur disa anëtarë tjerë.

Ish-drejtori i Administratës, Ilir Baldedaj në maj të këtij viti pat deklaruar se komisionet nuk i ka emëruar ai por kryetari i Komunës, në koordinim me Zyrën e Prokurimit. Ndërsa tenderët, sipas tij janë dhënë sipas vendimeve të OSHP-së, dhe se nuk merret drejtori me atë se kush e merr tenderin e kush jo.

Në fund të muajit tetor projekti “SmartCity Prizren” ka përplasur sërish kryetarin Haskuka me ish-drejtorin Baldedaj. Haskuka përmes një postimi në rrjetet sociale pat theksuar se qeverisja e kaluar ka kontraktuar një kompani për “Furnizim me software digjital për shërbim të qytetarëve në Komunën e Prizrenit”, me ç’rast buxhetit të komunës i janë marrë 28 mijë euro për një shërbim që nuk funksionon si duhet. “Komuna ka pranuar aplikacionin “SmartCity Prizren”, ndërsa kontrata e dhënë ka qenë 24,735 Euro. Sipas kontratës aplikacioni do të duhej të funksiononte në telefonat Android, IOS, dhe në web platformë, por fatkeqësisht në asnjërën prej tyre nuk punon. Gjersa në IOS (I Phone) dhe web nuk ekziston fare aplikacioni, ne mund ta shkarkojmë aplikacionin vetëm për Android. Por edhe kur e

instalojmë, ai nuk funksionon pothuajse fare dhe nuk ka asnjë shërbim për qytetarët... Për më tepër, komisioni nuk ka bërë pranimin teknik, por drejtori i qeverisjes së kaluar ka nënshkruar faturën dhe pastaj neve na janë marrë të hollat me përmbarues. Pra qytetarëve të Prizrenit u janë marrë 28,000 Euro me përmbarues për një shërbim që nuk funksionon. Rasti është dërguar organeve të gjyqësisë, që për habi janë përgjigjur se nuk ka elemente keqpërdorimi të detyrës!? Gjykoni vetë se si funksionon ky shtet!”, qe shprehur Haskuka.

Ndërkaq Baldedaj ka paralajmëruar se do ta padis kryetarin e Komunës, Mytaher Haskuka për shpifje. “Ankesës së Komunës për projektin “SmartCity Prizren” gjykata i është përgjigjur se nuk ka shkelje ndërsa adoleshenti Mytaher Haskuka, me postime në faqen e tij në FB e sfidon edhe vendimin e drejtësisë”, pat thënë Baldedaj. Ai ka theksuar se pretendimet e Haskukës nuk qëndrojnë, pasi që për funksionimin e programit është dashur që të ofrohen informatat nga secila drejtori. Sipas tij për këtë projekt janë zhvilluar të gjitha procedurat në mënyrë ligjore, ku është zhvilluar procedura tenderuese, me ç’rast fitues ka qenë kompania më e lirë, derisa “kompanitë tjera në vazhdim janë ankuar dhe pastaj vendimet i ka marrë OSHP-ja”.

EC për këto raste ka kërkuar sqarime nga Zyra e Prokurimit, dhe përgjigja që ka marrë ka qenë se pyetjet duhet orientuar tek ata të cilët i kanë shprehur këto dyshime.²⁰

e) **Moszbatimi i vendimeve të OSHP-së dhe padia e afaristit**

Në verën e këtij viti pronari i një biznesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Themelore kundër kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, me pretendimin se ai ka kryer disa vepra penale duke u vënë mbi Ligjin e Prokurimit Publik dhe vendimet e OSHP-së, në rastin e aktivitetit të prokurimit për “Shenjzimin vertikal dhe horizontal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit-Lot 2”. Padiësi ka shprehur qëndrimin se kryetari ka lejuar në mënyrë të kundërligjshme, pa kontratë dhe pa procedura tenderuese që të fillojnë punimet e sinjalizimit, ku vlera e punimeve shkon mbi 350 mijë euro.

Drejtori i NPTSH "Limit L&B" nga Prizreni , në cilësi të padiësit, si prova ka paraqitur vendimin e OSHP-së të datës 31 korrik 2017 për anulimin e dhënies së kontratës dhe kthimin në rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit, pastaj vendimin e OSHP-së të datës 12 shtator 2017 për anulimin e dhënies së kontratës dhe kthimin në rivlerësim, po ashtu vendimin e OSHP-së të datës 21 nëntor 2017 për anulimin e dhënies së kontratës dhe anulimin në tërësi të aktivitetit të prokurimit, sikurse edhe njoftimin nga Zyra e Prokurimit të Komunës së Prizrenit të datës 5 dhjetor 2017 për anulimin e dhënies së kontratës dhe njoftimin dërguar përmes emailit te operatori "Limit L&B" se ky proces i prokurimit anulohet dhe se do të ritenderohet.

Këto pretendime i ka hedhur poshtë Haskuka, duke theksuar se në këtë lëndë nuk ka marrë asnjë vendim dhe se puna për sinjalizimin... ka vazhduar sipas një kontrate ekzistuese nga qeverisja e kaluar, dhe se ky vazhdim është bërë për hir të sigurisë së qytetarëve.

²⁰ Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit, Përgjigje me email, datë 16 nëntor 2018.

Në fund të vitit të kaluar aktiviteti i prokurimit për shenjëzimin horizontal në rrugët e Prizrenit ishte anuluar në tërësi nga OSHP-ja. Ky organ në vendimin lidhur me këtë çështje pat theksuar se Komuna e Prizrenit mund ta ritenderoj këtë aktivitet të prokurimit nëse ka interes. Paneli shqyrtues i OSHP-së asokohe pat konstatuar se nuk ka oferta të përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit, me ç'rast sugjerohej Komuna që në të ardhmen dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ta hartojë konform nenit 28 të LPP-së.

Aktiviteti i prokurimit "Shenjëzimi vertikal dhe horizontal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit-Lot 2" i Komunës së Prizrenit disa herë ishte kthyer në rivlerësim. Madje në korrik të vitit të kaluar OSHP-ja pat gjobitur me 5 mijë euro Komunën e Prizrenit për mos zbatim të një vendimi paraprak dhe të një konkluzioni të këtij organi lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Krahas gjobës, OSHP pat anuluar vendimin e Komunës së Prizrenit për dhënie të kontratës dhe pat shfuqizuar kontratën që Komuna kishte lidhur me OE "Sinjalizimi" për këtë aktivitet të prokurimit. Ky aktiviteti i prokurimit ishte iniciuar qysh në gusht të vitit 2016.

EC ka kërkuar sqarime nga Zyra e Prokurimit për këtë rast, por përgjigja ka qenë që pyetjet t'i drejtohen zyrës së Kryetarit.

V. Rekomandimet

- Komuna e Prizrenit duhet të bëjë planifikim të mirëfilltë të projekteve, para se ato t'i nënshtrohen procedurave të prokurimit;
- Procedura e prokurimit të mos iniciohet pa projekt ekzekutiv;
- Komuna e Prizrenit mos ta iniciojë aktivitetin e prokurimit pa i siguruar mjetet e nevojshme për financimin e kontratës;

- Komuna e Prizrenit mos të lidhë kontrata publike jashtë planit vjetor të prokurimit;
- Projektet mos t'i nënshtrohen procedurave tenderuese nëse nuk janë përmbushur të gjitha kriteret ligjore për zbatimin e projektit;
- Të shtohet monitorimi në të gjitha fazat e prokurimit, nga njoftimi për kontratë e deri te menaxhimi dhe përmbyllja e kontratës;
- Të ndërmerren veprime shtesë nga Komuna që sigurojnë publikun se fondet publike përdoren në mënyrë efikase për të arritur vlerën për para;
- Të adresohen në përpikëri të gjitha rekomandimet e ZKA-së që kanë të bëjnë me prokurimin publik;
- Vendimet e OSHP-së të zbatohen nga Zyra e Prokurimit dhe lidhshipi komunal;
- Organet e drejtësisë t'i trajtojnë me efikasitet rastet e dyshimta të keqpërdorimeve që ndërliken me prokurimin publik.



Ky studim u hartua nga EC Ma Ndryshe, me mbështetje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

